



Për: Nënkryetarën e Komunës z. Marigona Lahu

Nga: Njësitit për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ

Raport i punës për 6 mujorin 2023:

Njësitit për të Drejtat e Njeriut funksionon në kuadër të organogramit organizativ si zyre e Kryetarit të Komunës ku përbëhet nga tre zyrtar me funksione përkatëse si:

Kordinatori i Njësitit për të Drejtat e Njeriut

Zyrtare për Barazi Gjiniore

Zyrtar për të Drejtat e Femive

Funksioni i Njësitit për të Drejtat e Njeriut si tërësi është për promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore si dhe realizimit sa më përfshirës të të drejtave të femive.

Njësitit për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ, gjatë kësaj periudhe kohore është angazhuar që ta realizoi planin e punës siq është paraparë me aktivitete që e përfshijn natyrën e punës të këtij njësitit.

Në funksion të kordinimit të punëve vazhdon bashkpunimi i ngushtë me nivelin qëndror përkatësisht MAPL, përkatësisht divizionin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe institucionet dhe agjensit përkatëse ose OJQ që meren me të drejtat e njeriut.

Kemi marrë pjesë në trajnime të organizuara nga MAPL si dhe OSBE dhe institucionet tjera si DEMOS, Avokati i Popullit.

Punoria DEMOS, korrniza e indikatorve treguesit për realizimin e të drejtave të njeriut ka qenë një puntori ku u përfshijn të gjitha metodat dhe metodologjit që ndikojn në treguesit në realizimin e të drejtave të njeriut në tërësi.

Kemi realizuar takime mujore me KFOR-in Hungarez, ku i informoim në tërësi për aktivitetet e njësitit si dhe punët e detyrat që kryhen në këtë njësit.

Në bashkpunim me zyren për komunitet dhe kthim përkatësisht udhëheqësin e zyrës kemi marrë një deyrë nga Kryetari i Komunës për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, që në mënyrë të tërësishme dhe të detajuar kemi vizituar edhe identifikuar të gjitha familjet e këtyre komuniteteve në vendbanimet në lagjen Xhafer Meta – Podujevë, Ali Ajeti- Podujevë, si dhe në fshatin Batallvë lagjia Kovaqët, në fshatin Lladoc si dhe në fshatin Orllanë, pas vizitave në këto fshatëra të këto komunitet jemi informue nga afër për kushtet e jetës, vëshërsit që preokupohen këto komunitet si dhe kushtet e banimit dhe infrastruktura e tërësishme duke përfshirë edhe shkollimin e nxënësve të këtyre komuniteteve.

Për të dhënat statistikore ne nuk do të përfshim në këtë raport pasi që udhëheqësi i zyrës për kthim i ka përfshirë në raportin e tij, ku i kemi të ilustruar edhe fotografi të bërë gjatë vizitës në teren.

Kemi vizituar zyrën për ndihmë juridike falas ku është biseduar lidhur me numrin e kërkesave të parashtruara në këtë zyrë, për ndihmën juridike që ofron kjo zyrë për rastet e shumta të kërkesave në skemat sociale që ankohen shfrytëzuesit e tyre si dhe çështje tjera të kësaj natyre. Është vazhduar me punët e parapara me objektivat e planifikuara.

Jemi informuar për vështirësitë që kanë disa kategori të personave me nevoja të veqanta për realizimin e të drejtave të tyre në skemat sociale dhe personale, siq janë kategorik Parapëlqjor dhe Tetlapëlqjor të cilët disa nga ta janë larguar nga skemat ndihmëse nga niveli qendror. Zrtari për të drejtat e fëmijëve ka realizuar aktivitet të parapara sipas planit të punës për të qenë koherent në funksion të realizimit sa ma përfshirëse të fëmijëve, është koordinuar me MAPL përkatsisht diivizionit për të drejtat e njeriut për të formuar ekipin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ku i ka procedue shkresat me kabinetin e Kryetarit përkatsisht zyren ligjore dhe u formua ekipi për brojtjen e drejtave të fëmijëve me vendim të Kryetarit ku me këtë ekip synohet që të jetë në funksion të realizimit të drejtave të fëmijëve konform ligjit 2019.

Zyrtarja për Barazi Gjinore-ZBGJ, është duke vazhduar me aktivitetet në koordinim me "OJQ" Aureola".

-Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike kemi marre pjesë në trajnimin me temë "Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës".

Ky trajnim është mbajtur me dt 24 shkurt 2023. ku jemi pajisue edhe me Certifikata

-Me Organizaten Demos kemi një bashkëpunim të ngushtë ku realizojme shumë trajnime në fusha të ndryshme ku do e veqoja edhe një trajnim që është realizuar me Zyrtares për informim ,ZBGJ, si dhe zyrtaret e lartë financiar, për të identifikuar sfidat problemet dhe qeshtje tjera rreth pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në komune. Ky takim është mbajtur me 20 shkurt 2023.

-Me Agjencionin për Barazi Gjinore kemi punuar duke marrë pjesë në punëtorit për harmonizimin e planeve të punës së ZBGJ me planin e ABGJ-së, si dhe me aktivitetet e parapara në PKBGJ. Takimi është mbajtur me 27 shkurt 2023

-Me 10 Mars në bashkëpunim me Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë (AWESK), kemi organizuar një Sesion Informues në komunën tone me temën "Gratë për gratë- Eficienca dhe kursimi i energjisë elektrike", i cili si projekt është i përkrahur nga Ministria e Energjisë.

-Java e Gruas 2023 Debatet mbi Politik

Java e Gruas (WoW) është një ngjarje vjetore mbarëkombëtare që mbledh në një mjedis ndëretnik, më shumë se 120 gra dhe burra nga partitë politike, shoqëria civile, biznesi, media dhe akademja, me qëllim të zgjerimit dhe forcimit të kapaciteteve të grave udhëheqëse dhe mbështetjes së tyre për të marrë pozicione të larta drejtuese. Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, WoW ka ofruar një platformë për debat mbi politika dhe diskutim intensiv me liderë politikë dhe zyrtarë të zgjedhur. Kjo u mundëson pjesëmarrësve t'i mbajnë përgjegjës përfaqësuesit e tyre dhe në të njëjtën kohë të mbështesin zhvillimin e shkathtësive për gratë në leadership në politikë

Sesioni eshte realizuar duke bashkepunuar me ZBGJ dhe anëtarët e Shoqatës AWESK, të profesioneve të ndryshme në sektor të energjisë e të cilat me prezantimet e tyre kane informuar audiencën lidhur me kursimin e energjisë, faturat, eficiencën e energjisë etj.

-Trajnim per Komitetin Komunan Veprues ,Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë,kemi marre pjese trajnimin për anëtarët e Komitetit të Veprimit Komunal (KKK-së) për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Romëve dhe Ashkalive. Komunitetet 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022- 2024.

Me organizaten UN WOMEN kemi nje bashkepunim te ngushte kukemi realizuar shume punetori dhe takime pune ku per analize kemi pasur drejtorin e Arsimit dhe si rezultat I punes se perbashket lidhur me te gjeturat e konstatuara dhe percaktimin e objektivave dhe indikatorve gjinor kemi punuar ne punetorin e mbajtur ne Shkup ne KAB 2023-2026 duke bere analize gjinore duke perfshire

- integrimin e objektivave gjinore
- Aktivitetet dhe indikatorët gjinore
- Te dhenate e ndara sipas Gjinitis
- Gjuhen e ndjeshme Gjinore

Me respekt!

Podujevë
Data:30.06.2023

Mr. Protokolit:



Kordinatori për të Drejtat e Njeriut